

BANKA E SHQIPËRISË

KARTËMONEDHA 1000 LEKË ME KURS LIGJOR

EMETIM I VITIT 2011



Ana e përparme



Ana e pasme

Nga data 3 qershor 2013, Banka e Shqipërisë hodhi në qarkullim kartëmonedhën me prerje 1000 Lekë me kurs ligjor, emetim i vitit 2011. Kartëmonedha ruan të njëjtën pamje dhe dimensione me ato të kartëmonedhës 1000 Lekë, emetim i vitit 1996, rishtypur në vitin 2001 dhe vitin 2007. Në kartëmonedhën e re janë shtuar apo përmirësuar elementë që kanë të bëjnë me sigurinë. Gjithashtu, kanë ndryshuar edhe firma e Drejtorit të Departamentit të Emisionit, si edhe viti i emetimit.

NDRYSHIMET KRYESORE NË EMETIMIN E VITIT 2011

Firma e Drejtorit



Viti



Filli i sigurisë nga 1.5 bëhet 2 mm i gjerë



KARTËMONEDHAT 1000 LEKË, EMETIM I VITIT 1996, 2001 DHE 2007, DO TË VAZHDOJNË TË KENË KURS LIGJOR DHE DO TË JENË NË QARKULLIM SË BASHKU ME KARTËMONEDHËN E RE, EMETIM TË VITIT 2011.